



Legal Alert Albania

Draft law “On electronic identification and trust services”

Draft law "On electronic identification and trust services"

This draft law comes as a necessity of defining the necessary legal framework for secure electronic identification, electronic signature, electronic seals, delivery of registered electronic service and authentication of websites, as well as guaranteeing a high level of security for electronic transactions in the Republic of Albania.

It aims to improve the current legal framework for electronic identification and trust services, as well as its full harmonization with Regulation (EU) No. 910/2014 of the European Parliament and of the Council, dated July 23, 2014 "On electronic identification and trust services on electronic transactions in the internal market", including provisions relating to electronic document, electronic identification and trust services.

Compared to the current legal framework, some of the innovations that this draft law brings include the following:

- increasing security and reliability requirements in the activity of qualified providers of trust services, where providers of these services must apply the most advanced security standards, appropriate to the risks associated with their activities in order to promote the trust of users;
- increasing cooperation between qualified providers of trust services with state and private institutions, through secure electronic identification schemes, in order to authenticate natural or legal persons;
- the draft law will introduce the trust list of qualified trust service providers and the list of certified devices for creating qualified electronic signatures and electronic seals, will regulate the long-term storage of information and the legal validity of electronic signatures and seals and will predict their valuation regardless of future technological changes.

The challenge of this draft law is the government's commitment to improving trust services, making possible an easier and faster access to information and services provided by providers, in order to ensure an efficient, transparent and responsible work of public administration, as well as the provision of good public services, suitable for the needs of citizens and businesses.

Another challenge of this draft law remains the membership of the Republic of Albania in the European Union. Part of the articles of Regulation (EU) no. 910/2014 of the European Parliament and of the Council, dated July 23, 2014 "On electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market, and repealing directive 1999/93/EC "(eIDAS) have not been transposed as they have as a condition Albania's membership in the European Union, so they are addressed only to member states.

Projektligji "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"

Ky projektligj vjen si nevojë e përcaktimit të kuadrit të nevojshëm ligjor për identifikimin elektronik të sigurt, nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, dorëzimin e shërbimit elektronik të regjistruar dhe autentifikimin e faqeve të internetit, si dhe garantimin e nivelit të lartë të sigurisë për transaksionet elektronike në Republikën Shqipërisë.

Ai synon të përmirësojë kornizën aktuale ligjore për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, si dhe harmonizimin e saj plotësisht me rregulloren (BE) nr.910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm", duke përfshirë dispozita që kanë të bëjnë me dokumentin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Në krahasim me kuadrin aktual ligjor, disa nga risitë që sjell ky projektligj janë:

- rritja e kërkesave të sigurisë dhe besueshmërisë në veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara, ku ofruesit e këtyre shërbimeve duhet të aplikojnë standardet më të përparuara të sigurisë, të përshtatshme për rreziqet që lidhen me aktivitetet e tyre në mënyrë që të nxitin besimin e përdoruesve;
- rritja e bashkëpunimit midis ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara me institucionet shtetërore dhe private, nëpërmjet skemave të identifikimit elektronik të sigurt, me qëllim autentifikimin e personave fizikë apo juridikë;
- ky projektligj do të prezantojë listën e besuar të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe listën e pajisjeve të certifikuara të krijimit të nënshkrimeve elektronike dhe vulave elektronike të kualifikuara, do të rregullojë ruajtjen afatgjatë të informacionit dhe vlefshmërinë ligjore të nënshkrimeve dhe vulave elektronike, si dhe do të parashikojë vlerësimin e tyre pavarësisht nga ndryshimet e ardhshme teknologjike.

Sfidë e këtij projektligji shihet angazhimi i qeverisë në përmirësimin e shërbimeve të besuara, duke bërë të mundur një qasje më të lehtë dhe të shpejtë në informacion dhe në shërbimet e ofruara nga ofruesit, me qëllim sigurimin e një pune efikase, transparente dhe të përgjegjshme të administratës shtetërore, si dhe ofrimin e shërbimeve të mira publike, të përshtatshme për nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.


Një tjetër sfidë e këtij projektligji mbetet anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Një pjesë e neneve të Rregullores (BE) nr.910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon direktivën 1999/93/KE" (eIDAS) nuk janë transpozuar pasi kanë si kusht anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pra u adresohen vetëm shteteve anëtare.

How can PwC Albania help?

With the entry into force of this draft law, PwC can help interested stakeholders in identifying persons who are subject to these provisions, prepare the necessary documentation and follow the legal procedures respecting the provisions of the Albanian legislation.

Si mund të ndihmojë PwC Shqipëri?

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, PwC mund të ndihmojë të gjitha palët e interesuara në identifikimin e personave që janë subjekt të këtyre dispozitave, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe ndjekjen e procedurave ligjore duke respektuar dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1
Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

